



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më __. __. 2025

PROJEKT – VENDIM
Nr. __, datë __. __. 2025

“MBI NJË NDRYSHIM TË VKB NR.25, DT.28.05.2024 DUKE SHTUAR NË LISTËN E KËTIJ VENDIMI SI PËRFITUES”

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodi të Procedurës Administrative, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrorenë qarqet Durrës dhe Tiranë” të ndryshuar, Vendimit nr.887, datë 24.12.2019 “për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, VKM nr. 904, datë 24.11.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar.

TË VENDOSI:

- Ndryshimin e VKB Nr.25, duke shtuar në listën e këtij vendimi, si përfitues i programit të rindërtimit, të një apartamenti banimi, me tipologji 1+1, të subjektit Petro Doja, Vjollca Doja.

-Ky Projekt – Vendim, pasi të miratohet nga Këshilli Bashkiak, hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

DREJTORIA I GJORE
Adrian MALAJ

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE
Dritan KAZAZI

DREJTORIA E BUREMEVE EKONOMIKE
Andi GURC

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Dëshira QATO

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Meri BITURKU



KRYETARI

Enik QOSJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KOMISIONI I POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT,
VLERËSIMIN DHE RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKUARA NGA
QYTETARËT

Nr. ____ Prot.

Datë, __. __. 2025

Lënda: Raport mbi propozimin e subjekteve përfitues sipas kategorive:

- Miratimin e ndryshimit të VKB nr. 25, dt. 28.05.2024, duke shtuar në listën e këtij vendimi si përfitues subjektin Petro Doja, Vjollca Doja.

Kryetarit të Bashkisë
Z. Fisnik Qosja

Komisioni i ngritur me Urdhërin Nr.31, datë 05.02.2025 me Nr. 604 Prot. të datës 05.02.2025. "Për një ndryshim të Urdhërit Nr.917, datë 12.12.2023 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësimin dhe rivlerësimin e dosjeve të aplikuara nga qytetarët për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë", kanë shqyrtuar të gjithë dokumentacionin që administrohet në dosjet e aplikimeve të çdo qytetari. Komisionet janë në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodi të Procedurës Administrative, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrorenë qarqet Durrës dhe Tiranë" të ndryshuar, Vendimit nr.887, datë 24.12.2019 "për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore", VKM nr. 904, datë 24.11.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", VKM nr. 301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët".

Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

KOMISIONI I POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT,
VLERËSIMIN DHE RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKUARA NGA
QYTETARËT

Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;
- b) numrin e kërkesës;
- c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
- ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit;
- d) adresën e kërkesës;
- dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
- e) Aktin e konstatimit/akt-ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licensën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme;
- ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Përfutues që kalon në strehim në apartament si shtesë VKB Nr. 25 dt.28.05.2024

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për dosjen e z. Petro Doja dhe znj. Vjollca Doja, Komisioni pas sqarimit nga Drejtoria Ligjore, e cila ka vlerësuar se:

„Në dosjen e cila administrohet nga komisioni rezulton se kërkesit Petro dhe Vjollca Doja kanë në pronësi dy apartamente banimi, apartamentin me nr. 8/61+1-4, me sipërfaqe 44.8 m2, i cili ndodhet në Zonën Kadastrale 8551 dhe apartamentin me nr. 7/34+4-4, me sipërfaqe 67 m2, i cili ndodhet në Zonën Kadastrale 8552.

Apartamenti me nr. 8/81+1-4, me sipërfaqe 44.8 m2 ndodhet në pallatin i cili është dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, me shkallë dëmtimi DS4, për të cilin është marrë vendimi për prishje.

Familja përbëhet nga katër persona, kryefamiljari dhe bashkëshortja, i biri i datëlindjes 1990 dhe e bija e datëlindjes 1992. Kjo është përbërje e cila është e datës 26.11.2019.

Në nenin 8 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 „Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, cilësohet se strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standartave të ndërtimit, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KOMISIONI I POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT,
VLERËSIMIN DHE RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKUARA NGA
QYTETARËT

Gjithashtu, edhe në nenin 4, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", cilësohet se strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson: a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në VKM nr. 301, datë 15.04.2020 „Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira, që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët“, norma e strehimit për programet e strehimit social, në përputhje me parimet e politikave të strehimit, bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr. 22/2018, „Për strehimin social“, është 30 m², sipërfaqe neto për personin e parë.

*Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10 m² dhe llogaritet sipas formulës më poshtë: Sipërfaqja Neto e Banesës = 20 m² + N * 10 m², ku: Sipërfaqja Neto e banesës është sipërfaqja e shfrytëzimit pa muret e brendshme dhe perimetrale, e quajtur ndryshe si sipërfaqja e përdorshme ose e shkëljes. N është numri i banorëve mbi moshën 5 (pesë) vjeç.*

Banesë e mbipopulluar quhet ajo banesë që plotëson njërin ose disa prej kushteve të mëposhtme: a) Kur ka sipërfaqe banimi neto më të vogël se norma e strehimit; b) Kur më shumë se dy persona që shfrytëzojnë një dhomë gjumi; c) Kur dy persona me seks të ndryshëm mbi moshën 10 vjeç dhe që nuk janë në lidhje martesore ose bashkëjetese shfrytëzojnë një dhomë gjumi.

Në apartamentin me nr. 7/34 + 4 – 4, me Sipërfaqe 67 m², i cili ndodhet në Zonën Kadastrale 8552, i cili ka përbërje prej dy dhoma dhe një kuzhinë, dy dhoma gjumi nuk janë të mjaftueshme për një familje prej katër persona, të cilët janë një çift, dhe 2 fëmijë të rritur të seksit të ndryshëm, të cilët duhet të kenë nga një dhomë secili.

Ndaj duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që përmenda më lart, rezulton se, familja e cila ka bërë kërkesën për tu trajtuar me apartament banimi, i plotëson kushtet e përfitimit nga programi i rindërtimit, si familje e prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019, pasi apartamenti

ekzistues nuk i plotëson kërkesat e një strehimi të përshtatshëm sipas kërkesave të ligjit për strehimin.

Për sa me lart, Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e ankesave të disa qytetarëve të cilët kanë qenë përfitues me VKB dhe për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë, sipas vlerësimit të Drejtorisë Ligjore, kërkon ndryshimin e VKB nr. 25, datë 28.05.2024, duke shtuar subjektin

Petro Doja dhe Vjollca Doja si përfitues nga programi i rindërtimit apartament banimi, me tipologji 1+1,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KOMISIONI I POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT,
VLERËSIMIN DHE RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKUARA NGA
QYTETARËT

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	NR. PERSONAVE SIPAS ÇERTIFIKATAVE FAMILJARE	Tipologji Apartament e Përfituar
1	Petro Doja, Vjollca Doja	4	1+1

Kjo familje përfiton apartament banimi të tipologjisë 1+1, në zonat e reja të rindërtimit pasi numri i anëtarëve është konsideruar për një person, që në këtë rast specifik, është i biri ose e bija, sepse sipas Udhëzimit parashikohet që deri në dy anëtarë masa e përfitimit është përkatësisht 1+1, masë e cila, përkon edhe me tipologjinë e apartamentit në objektin pallat që i nënshtrohet prishjes së detyruar.

Sipas certifikatës familjare rezulton se kjo familje përbëhet nga 4 persona të rritur, bashkëshorti, bashkëshortja, i biri dhe e bija. Si rrjedhim të kushteve të tyre familjare, Petro dhe Vjollca Doja përkatësisht bashkëpronarë të dy pronave, apartament me tipologjinë 1+1, kanë qenë të strehuar dhe në një apartament tjetër me sipërfaqje prej 67 m², pra 2+1, që në këtë rast përmbushin normat minimale të strehimit. Sipas sqarimit të bazës ligjore të parafrazruar më lart, dhe si pasojë e nënshtimit të prishjes së detyruar të objektit pallat ku kjo familje posedon një apartament 1+1, komisioni i përmbahet këtij sqarimi ligjor.

Anëtarët e Komisionit

Julian Hoxha

Genç Gjylsheni

Erdi Berati